

NENI 5

SHPRONESIMI

1. Investimet e investitoreve te seciles Pale ne territorin e Pales tjetër nuk do te shpronesohen, shtetëzohen ose nuk do te jene subjekt i ndonjë mase tjetër që ka efekt ekuivalent me atë të shpronesimit apo të shtetëzimit (ketu me poshtë referuar si “shpronesim”), me përjashtim kur kërkohet për interes publik, mbështetur në ligj, mbi baza jodiskriminuese dhe me anë të pageses së menjëhershme, të pershtatshme dhe një kompesimi efektiv.
2. Ky kompesim do të llogaritet sipas vlerës reale të tregut të investimit të shpronesuar, në momentin përpara se shpronesimi të kryhet ose përpara se ky shpronesim të bëhet publikisht i njohur, cilido është me i hershmi (ketu me poshtë referuar si “datë vlerësimi”).
3. Kjo vlerë tregu do të shprehet në një monedhë lirisht të konvertueshme me kursin e këmbimit që mbizoteron në treg dhe do të ketë garanci deri në datën e vlerësimit. Kompesimi do të përfshijë interesin e zakonshëm tregtar të percaktuar sipas kritereve të tregut për monedhën e vlerësimit, prej datës së shpronesimit deri në datën e pageses. Kompesimi do të paguhet pa vonesë dhe do të jetë efektivisht i realizueshem e lirisht i transferueshem.
4. Investitori i prekur gëzon të drejtën, sipas ligjit të Pales që bën shpronesimin, për një shqyrtim të menjëhershëm nga ana e autoriteteve gjyqësore apo kompetente të kësaj Pale, të rastit të tij, duke përfshirë vlerën e investimit të tij dhe pagesën e kompesimit në përputhje me parimet e vendosura në këtë Nen.
5. Kur një Pale shproneson pasuritë e një shoqërie e cila është krijuar apo themeluar sipas legjislationit në fuqi në çdo pjesë të territorit të saj, dhe në të cilën investitorët e Pales tjetër zoterojnë aksione, ajo do të sigurojë që dispozitat e këtij Neni të zbatohen si garanci për një kompesim të menjëhershëm, të pershtatshëm dhe efektiv në lidhje me investimin e tyre ku investitorët e Pales tjetër janë zotërues të këtyre aksioneve.

NENI 6

KOMPENSIMI PER HUMBJET

1. Investitoret e nje Pale, investimet e te cileve pesojne humbje ne territorin e Pales tjeter per shkak te konfliktit te armatosur, revolucionit, gjendjes se emergjences kombetare, kryengritjeve, luftes civile ose ngjarjeve te ngjashme, do t'u jepet nga kjo Pale ne lidhje me kthimin, zhdentimin, kompensimin ose ndonje zgjidhje tjeter te vlefshme, nje trajtim jo me pak i favorshem se sa kjo Pale i jep investitoreve te vet ose te nje shteti te trete, cilido qofte me i favorshmi prej tyre per investitorin. Pagesat e rezultuara do te jene lirisht te transferueshme.
2. Pavaresisht nga paragrafi 1, nje investitori te nje Pale, i cili, ne secilen nga situatat e referuara ne kete paragraf, peson humbje ne territorin e Pales tjeter qe rezulton nga :